

# ANALIZA VJETORE PËR VITIN 2024 TË KLSH-SË



10 Shkurt 2025

**Në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr. 13, datë 16.01.2025, më datë 10.02.2025, në ambientet e KLSH-së, u zhvillua analiza vjetore për vitin 2024.**

Në këtë analizë morën pjesë Kryetari i KLSH-së, Sekretari i Përgjithshëm si dhe Drejtorja Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit, Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Financës.

Takimi u hap me një fjalë përshëndetëse nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Arben Shehu, i cili falënderoi punonjësit për angazhimin e tyre të deritanishëm dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë midis strukturave të ndryshme të institucionit. Z. Shehu theksoi se zhvillimi i një komunikimi të qartë dhe efektiv është thelbësor për zgjidhjen e shpejtë të çdo problematike dhe për përmirësimin e efikasitetit të punës.

Një vëmendje e veçantë në analizë iu kushtua përvjetorit të 100-të të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku Kryetari kërkoi angazhim maksimal nga të gjitha strukturat për të shënuar këtë moment historik të institucionit.

Sekretarja e Përgjithshme, znj. Valbona Gaxha, ndau vlerësimet për punën e kryer nga strukturat në varësi të saj dhe theksoi rëndësinë e rritjes së eficiencës së proceseve të punës.



Drejtuesit e drejtorive prezantuan veprimtarinë e vitit 2024, problematikat e hasura dhe paraqitën sfidat e reja duke shprehur përkushtim për përmbushjen e detyrave institucionale.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë vitit 2024 ka vijuar intensifikimin e bashkëpunimit me SAI-et homologe, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të reja dhe trajnimeve të vazhdueshme të stafit, me synim shkëmbimin e eksperiencave dhe rritjen e kapaciteteve profesionale.